

UDC 343.9:024.336.7

343.1 (497-7)

Mevledin MUSTAFI¹

**DREJTËSIA LIGJORE DHE ASPEKTET HISTORIKE TË
PARAQITJES SË KRIMINALITETIT**

**ЗАКОНСКАТА ПРАВДА И ИСТОРИСКИТЕ АСПЕКТИ НА
ПОЈАВУВАЊЕТО НА КРИМИНАЛОТ**

**LEGAL JUSTICE AND HISTORICAL ASPECTS OF
THE CRIME**

Abstract

In verily, although close to one another, they have differences between them. During its historical development man has harmonized, socialized, where this side is the key feature of man as human being. It develops as a consciousness in the working process, interpersonal communication, social relationships that develop between people. In support of the history and creation of human society in some level can be ascertained that the man is complicated being, and we in the following will try to concretizing it more in its different views. In science, in a far extent, also in our life we face with the concepts man, individual, personality, individuality, often we give them different meanings.

Key words:

Proceeds of crime In verily, sanction, specific provisions, money laundering,

1. Qasja e përgjithshme për kriminalitetin si dukuri shoqërore negative dhe e rrezikshme

Kriminaliteti si dukuri shoqërore–negative dhe e rrezikshme paraqet dukuri shoqërore e cila manifestohen në forma të ndryshme gjatë tërë rrjedhës së historisë njerëzore. Historikisht është

¹ Doc.dr. i shkencave juridiko-penale dhe specialist në lëminë e kriminaliteti doganor në Republikën e Maqedonisë

vërtetuar se që në nga ditët e hershme të ekzistimit të shoqërisë njerëzore, qysh në bashkësinë primitive, ka pasur jo vetëm devijime, por edhe forma të tjera të sjelljes ekcesive, të cilat i lëndonin rregullat, vlerat, dhe marrëdhëniet shoqërore të jetës në të cilat ajo qëndronte.² Mirëpo, format e shkeljes së rregullave të tilla të sjelljes dhe mënyra e reagimit ndaj sjelljeve të tilla kanë ndryshuar gjatë zhvillimit të bashkësisë njerëzore në përputhje me lidhjet ekonomike, e lidhur me këtë edhe me ato kulturore. Me kalimin e kohës me shtresimin klasor të shoqërisë, për shkak të ndikimit të kushteve ekonomike në jetën e të gjithë anëtarëve të shoqërisë së organizuar në shtet, kriminaliteti bëhet dukuri shoqërore më masive. Andaj, me qëllim që me sukses të zhvillohet lufta kundër tij, në shoqërinë me klasa paraqitet instrumenti i posaçëm, e drejta me të cilat rregullohen sjelljet e caktuara.³

Çdo njëra prej shoqërive njerëzore inkriminon në normat e veta pozitivo–juridike aktivitetet të caktuara, që organet e “pushtetit publik” ua japin karakterin e aktiviteve të rrezikshme shoqërore dhe parashohin sanksionet në rast të shkeljes së tyre. Kriminaliteti është një dukuri shoqërore që në mënyrë të ndryshme manifeston veprime negative dhe në kuptimin shoqërorë lë rrjedhime të dëmshme. Veprimi i tillë negativ manifestohet në radhë të parë kundër të mirave dhe vlerave materiale, përveç këtyre të mirave materiale, si objekt i sulmit të aktivitetit kriminal janë edhe vlerat shoqërore nga pikëpamja e kuptimeve morale në ambientin e dhënë shoqëror. Këtu vijnë gjithashtu edhe vlerat e ndryshme politike, kulturore e të tjera të shoqërisë, që i krijon shoqëria në procesin e zhvillimit të vet. Në të gjitha këto mira e vlera kur këto bien nën goditjen e aktivitetit kriminal, ky aktivitet lë rrjedhime negative e shkatërruese.⁴

2. Si dukuri e veçantë dhe shoqërore kriminaliteti i ka rrënjët e veta, shkaqet e veta, historinë e vet dhe manifeston ndikime të caktuara

Si dukuri e veçantë dhe shoqërore kriminaliteti i ka rrënjët e veta, shkaqet e veta, historinë e vet dhe manifeston ndikime të caktuara varësisht nga rrethanat dhe rastet, në sfera të ndryshme të jetës ekonomike, politike, juridike, morale, kulturore etj. Për shkak të natyrës se vet shkatërruese, krimi përherë ka zgjuar frikë, pasiguri, dhe tmerr ndër qytetarët, duke shtuar në të njëjtën kohë

² Bashkim Dr. Selmani “Kriminologjia dhe penologjia” f. 12-19. Prishtinë, 2014

³ Sahiti, Ejup. E drejta 1/1995, Prishtinë, f. 13-14.

⁴ Milutinović, Milan. *Kriminologjia*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 297-298.

edhe interesimin për të. Prandaj në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore është shprehur një interesim i veçantë për natyrën, shkakun dhe motivet e krimit si dhe për pasojat shpesh tragjike dhe mënyrën e pengimit të tij.⁵

Që në fillim të shekullit XX gjithnjë e më tepër bëhet e qartë se kriminaliteti i të rriturve dhe delikuenca e të miturve nuk janë vetëm nocione juridiko-penale. Këto dy fenomene paraqesin dukuri të ndërlikuara shoqërore për kufizimin dhe luftimin e të cilave nevojitet organizim i gjithanshëm i shoqërisë dhe i shkencave të ndryshme, kështu që trajtimi juridiko-penal i këtij fenomeni është vetëm një aspekt i trajtimit të çështjes. Kërkimet kriminologjike dhe sociologjike kanë kontribuar në mendimin se kriminaliteti është dukuri e kushtëzuar nga shoqëria, kurse kriminelit në masë më të madhe apo më të vogël, rezultat i ndikimeve dhe raporteve të caktuara shoqërore.⁶ Pikëpamjet dhe mendimet e hershme mbi kriminalitetin kanë rrugën e vet të zhvillimit, duke filluar nga mendimet e hershme të karakterit filozofik dhe teologjik të kriminalitetit deri te teoritë dhe mendimet e shkollave juridiko-penale mbi kriminalitetin. Në këtë kuptim çështjet e sigurisë fitojnë një kuptim dhe rëndësi të re, para së gjithash në drejtimin dhe punën efektive të subjekteve të sistemit të sigurisë në kushtet bashkëkohore. Vetëm një personel i arsimuar dhe i përgatitur mirë mund të krijojë nënsisteme transparente, demokratike dhe komunikative, me objektiva të qarta, strategji të definuar për kryerjen e detyrave në procesin e modernizimit.⁷

3. Proces që duhet të bazohet në njohuritë teorike dhe shkencore si drejtësi ligjore

Ky proces duhet të bazohet në njohuritë teorike dhe shkencore, operacionalizimi konkret dhe praktik i të cilave duhet të sigurojë një rol të pranueshëm të subjekteve të sistemit, që është me interes reciprok e të përbashkët për zgjidhjen e problemeve të sigurisë. Siguria nuk është vetëm shqetësim i organeve të sigurisë, por edhe shqetësim për të gjithë qytetarët. Për këtë arsye mekanizmat e sigurisë duhet të kenë vend të respektuar në shoqëri dhe këtë mund ta arrijnë vetëm duke vepruar në bazë të njohurive dhe të arriturave shkencore e profesionale.

⁵ Halili, Ragip. *Kriminologjia*, Prishtinë, 2008, f. 10.

⁶ Latifi, Vesel. *E drejta I/1997*, Prishtinë, f. 29.

⁷ Bashkim Dr. Selmani “Krimi i organizuar dhe terrorizmi”- Universiteti i parë privat „FON”-Shkup 2010

Për t'i përmirësuar institucionet dhe ligjet e veta, duke i bërë ato të drejta, anëtarët e shoqërisë mund të diskutojnë lirisht dhe t'i paraqesin kërkesat e tyre legjitime. Secili mund të paraqesë lirisht argumentet për qëndrimet e veta racionale. Ata që janë të aftë të mendojnë në mënyrë kritike gjithmonë e kanë mendimin e vet mbi shoqërinë, mbi vlerat e saj pse mbi mungesën e tyre, problemet dhe mundësitë për zgjidhjen racionale të tyre. Do të ishte ideale nëse mendimi kritik do të kishte mundësi që vështrimin mbi shoqërinë dhe institucionet e ligjet e saj të jetë i respektuar gjet zgjidhjes së të gjitha çështjeve që e preokupojnë shoqërinë. Natyrisht, kësaj i kundërvihet politika e pseudo-intelektualëve, të cilat i ruajnë pozicionet, kolltukët, rrogat e mira dhe beneficionet tjera. Në interes të funksionimit të drejt të institucioneve dhe ligjeve, në bazë të të cilave veprojnë, i cili është në interes të të gjithë anëtarëve të shoqërisë, është e nevojshme të dëgjohet mendimi kritik, i cili duhet të jetë gjithmonë i gatshëm të diskutojë lirisht mbi institucionet dhe ligjet dhe të parashtrijë kërkesat e veta legjitime, me qëllim të përmirësimit të institucioneve dhe ligjeve.⁸

4. Revolucioni informativ edhe përkundër të mirave që ka ofruar, megjithatë ka edhe anën e vet negative.

Ndryshimet e mëdha dhe të shpejta në sferën e teknologjisë informative dhe teknologjike të shumë shteteve bashkëkohore dhe aplikimi i kësaj teknologjie në automatizimin e proceseve të punës në të gjitha sferat e jetës ekonomike e shoqërore, paraqesin një fenomen të vërtetë të së sotmes. Në kuadër të kësaj, zhvillimi i elektroteknikës dhe perfeksionimi i përhershëm i funksionimit të pajisjeve kompjuterike në sferat e ndryshme të veprimtarive të personave fizikë dhe juridikë, duke filluar nga prodhimi, qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve e deri te mbrojtja dhe siguria kombëtare në kuptim më të gjerë, kanë rezultuar që nga ana e një kategorie të grupeve dhe personave të papërgjegjshëm, të cilët me sjellje të kundërligjshme duke shfrytëzuar kompjuterin dhe komponentët e tij, t'u sjellin vetit apo të tjerëve përfitime të kundërligjshme dhe njëkohësisht me veprimet e tyre u shkaktojnë dëme materiale personave fizikë, institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi.

⁸ Bashkim Dr. Selmani "Kriminologjia dhe penologjia" f. 12-21. Prishtinë, 2014

Shoqëria bashkëkohore sot ballafaqohet me të arriturat më të mëdha të zhvillimit tekniko-teknologjik, të cilën e përcjellë ekspansioni i shpejtë i teknologjisë informative dhe automatizimi i proceseve të punës në të gjitha sferat e jetës ekonomike dhe shoqërore. Ky zhvillim në shoqërinë bashkëkohore ka sjellë një numër të madh lehtësirash në njërën anë, ndërsa në anën tjetër keqpërdorimi i paramenduar i këtyre të arriturave teknologjike, ka krijuar edhe një numër problemesh dhe rreziqesh në shoqëri në përgjithësi.

Sot, teknologjia informative prekë çdo aspekt të jetës pa marrë parasysh vendndodhjen e saj në rruzullin tokësor. Revolucioni informativë edhe përkundër të mirave që ka ofruar, megjithatë ka edhe anën e vet negative.

5. Koncepti arsimor i orientuar drejt së ardhmes

Koncepti arsimor i orientuar drejt së ardhmes është një instrument shumë i fuqishëm për përshtatjen dhe vitalitetin e strukturave organizative të sigurisë ndaj sfidave të së ardhmes. Përveç avancimit të sistemit arsimor në pajtim me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë bashkëkohore, pajisjes me mjete materiale e teknike, shfrytëzimit të të arriturave shkencore dhe shfrytëzimit të mjeteve të informimit e komunikimit, rëndësi të veçantë ka sistemi i udhëheqjes sidomos në kryerjen e aksioneve në situata komplekse të sigurisë. Vetëm një sistemim i udhëheqjes, i cili bazohet në të arriturat shkencore dhe në zbatimin e koncepteve, parimeve, metodave, taktikave dhe teknikave bashkëkohore mund të realizojë me sukses detyrat strategjike operative për arritjen e objektivave konkrete, të cilat janë cak i vizionit të forcave demokratike të sigurisë.⁹

Por, ç'bëjnë studiuesit e kësaj sfere shkencore për të mënjeluar dhe alarmuar se pikërisht mos njohja e këtyre teknikave të veprimit kriminal po bënë përkeqësimin e thellë të opinionit publik kur tani më pasuria lakmon dhe tërheq në vete çdo njeri. Po, kaq e rëndësishme sot, është që të njihemi me krimin sepse shpeshherë edhe ne vet dhe fëmijët mund të jemi pjesë e krimin, nëse atë nuk e studiojmë dhe nëse nuk i edukojmë njerëzit dhe brezat e rinj nga rreziqet që po kanos kriminaliteti i organizuar në shoqërinë bashkëkohore shqiptare.

⁹ Bashkim Dr. Selmani "Krimi i organizuar dhe terrorizmi"-Univeristeti i parë privat „FON”-Shkup 2010

6. Shoqëria shqiptare është më shumë se kurrë e prekur nga krimi dhe kriminaliteti

Shoqëria shqiptare është më shumë se kurrë e prekur nga krimi dhe kriminaliteti, dhe në rast se heshtet sikur është heshtur deri më tani krimi po bëhet përditshmëri sa që njerëzit po t'i dëgjojnë lajmet e dinë se çdo fjali do të fillojë dhe mbarojë me krimin dhe kriminalitetin e organizuar. Gjurmimi historik ndër shqiptarët ka treguar se tendencat dhe autorët e krimeve zakonisht i kanë bërë pjesa më e pakulturuar dhe më e pashkolluar e njerëzve apo e shoqërisë tonë. Shtrohet pyetja a është vallë edhe sot një gjë e këtillë praktike! Unë ju garantoj se jo sot, pikërisht kur ka ndryshuar psikologjia e të menduarit shqip kriminaliteti i ka thyer këto postulate dhe mund të konstatojmë me përgjegjësi se pikërisht sot, është një moment tjetër ku pikërisht njerëzit më të aftë dhe më të shkolluar kryejnë krime të sferave të ndryshme penale, duke filluar nga zyrtarët deri tek shofer zyrtarë. E them këtë se pse shpesh njerëzit dhe zyrtarët pa vetëdije dhe dashje hyjnë në errësirën e bunkerit të quajtur lakmia për pasuri pa ditur se çfarë qëndron në atë bunker të hermetizuar.

Gjithashtu, është me rëndësi që udhëheqja është edhe profesioni që, përveç dijes, kërkon edhe përgatitje shkencore për ndërtimin e marrëdhënieve njerëzore brenda strukturës organizative shtetërore për të njohur nga afër publikun nga rreziqet e mundshme. Për t'iu përshtatur kërkesave të shoqërisë pa imponuar korrupsionin dhe rrugën kriminale kushtëzuese për të kryer një shërbim institucionalo-administrativ.

Parë në këtë prizëm, mund të konstatojmë se si parakusht për këtë është ndërtimi i marrëdhënieve të tilla brenda strukturave të sigurisë, të cilat do të mundësojnë që zhvillimi i tyre të bëhet në pajtim me parimet e barazisë, tolerancës, durimit dhe aftësisë. Kjo nënkupton respektimin e filozofisë së udhëheqjes e cila përfshin komponentët politike, juridike, strategjike, taktike, etj. Me rastin e hartimit të planeve globale operative, sidomos kur bëhet fjalë për masa operative, vjen në shprehje autoriteti dhe njohja e problematikës nga struktura udhëheqëse. Në këtë mënyrë mund të përcillet shkalla e realizimit të objektivave dhe të jepen këshillat e domosdoshme të veprimit, të cilat do të ndihmojnë orientimin e veprimit efikas. Çdo sistem i sigurisë së një shoqërie kujdeset për realizimin e detyrave për të cilat është përgatitur.

1. Përfundimi

Sistemi bashkëkohor i udhëheqjes duhet të arrijë objektivat e përcaktuara në bazë të strategjisë së përbashkët edhe të politikës së sigurisë dhe strategjisë së sigurisë në luftë kundër kriminalitetit, çdo vdekje sot, është më e komplikuar, për ta zbardhur në rast se nuk do të ishin të sofistifikuara metodat dhe teknikat e ekspertimit mjeko-ligjor. Për këtë arsye, shërbimet udhëheqëse, në të gjitha nivelet hierarkike të organizimit dhe të autorizimeve e përgjegjësi, ka rol vendimtar në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me bashkësinë shoqërore në relacion individ-shtet dhe shoqëri.

Në qoftë se marrëdhëniet midis elementeve të sistemit të udhëheqjes janë në nivel të kënaqshëm, atëherë edhe marrëdhëniet midis niveleve të ndryshme të forcave kundër kriminit të organizuar të shtetit do të jenë në pajtim me objektivat e përcaktuara nga mekanizmat legjitim të shtetit. Kjo mund të arrihet vetëm në kuadrin e atyre strukturave që kanë komponenta të zhvilluara organizative, strategjike, nëpërmjet metodave të veçanta dhe njëkohësisht të ekspertëve kadrovike me një ndërgjegjshmëri më të madhe profesionale me, përpjekje për të evituar mendimet e shëmtuara që po gllabërojnë çdo ditë e më shumë shoqërinë shqiptare pa marr para sysh se në cilat troje jetojnë ata sot. Edhe sistemi i sigurisë, nëpërmjet një sërë bartësish dhe subjektësh synon të përmbushë funksionin dhe të realizojë detyrat e tij për arritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e situatës së sigurisë, me theks të veçantë në mbrojtjen e qytetarëve dhe në sigurinë personale të pasurisë së tyre. Nga kjo që thamë mund të konstatojmë se sa më e lartë që të jetë gjendja e sigurisë në shtet aq më e vështirë do të jetë mundësia për kriminalitetin dhe devijimet e tjera kriminale në shoqëri

BIBLIOGRAFIA

1. Altin Dr. Shegani “*E drejtë penale e krahasuar*” Tiranë, 2002
2. Bashkim Dr. Selmani “*Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi ndërkombëtar*” Botues: Universiteti i parë privat „FON”- Shkup, 2008.
3. Afrim Dr. Osmani “Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime” Shkup, 2010.
4. Jean Pradel & Geert Corstens & Gert Vermeulen “*E drejta penale evropiane*” Dalloz, 2009.

5. Criminal justice system in Europe, *Evropean Institute for Crime prevention and Control* (United Nations)
6. Vesel Dr.Latifi “*Kriminalistika*” Prishtinë, 2011.
7. Ragip Dr.Halili “*Viktimologjia*” Prishtinë, 2011.
8. Ragip Dr. Halili “*Kriminologji*” Prishtinë, 2008.
9. Ergyn Qapan “*Një vështrim Islam mbi terrorizmin dhe sulmet vetëvrasëse*” Tiranë 2004.
10. Ismet Dr. Elezi & Vasilika Hysi “*Politika Kriminale*” Tiranë, 2001.
11. Rexhep dr. Gashi “*Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri*” Tiranë, 2001.

KODET PENALE TË DISA SHTETEVE:

- ✓ Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- ✓ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- ✓ Kodi penale i Republikës së Maqedonisë
- ✓ Kodi penal i Gjermanisë
- ✓ Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë